

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5609
E martë, 23 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Gjykata Supreme përsëri bllokon lirimin e Sylejman Selimit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

TRANZICIONI I FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS (FSK) NË USHTRI DO TË BËJË QË KJO FORCË TA SHTOJË NUMRIN E PJESËTARËVE TË SAJ

Ushtria e Kosovës do t'i ketë 8 000 ushtarë



Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri nuk do t'ia ndryshojë vetëm misionin kësaj force, por edhe numrin e pjesëtarëve. Komandanti i FSK-së, gjeneralallejtënant Rrahman Rama, ka bërë

me dije për gazetën "Epoka e re" se kjo forcë do t'i ketë 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë. "Do të ketë rritje qind për qind. Rekrutimi i parë do të jetë në fillim të vitit të ardhshëm", ka thënë gjeneralallejtë-

nant Rama. Po të hënën edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se me formimin e ushtrisë do të shtohet nevoja për rekrutimin e pjesëtarëve të ri në këtë forcë

Policëve do t'u rriten pagat mbi 100 euro



Me ligjin e ri të pagave pjesëtarëve të Policisë së Kosovës do t'u rriten pagat mbi 100 euro. Policët të ri paga do t'i rritet 105 euro, policët të lartë 129 euro, rreshterit 118 euro, togerit 124 euro, kapitenit 148 euro, majorit 69 euro dhe nënkolonelit 27 euro në muaj

Kërkohet më shumë mbështetje institucionale për viktimat kriminale



AKTUALE

BAHTIRI KËRCËNOHET ME VDEKJE, SHKAK HAPJA E URËS MBI IBËR F. 8

BYTYQI DHE PËRFAQËSUESIT E FMN-SË DISKUTOJNË PËR MËSIMDHËNËSIT E VITEVE '90 F. 8

IKD-ja KËRKON DEKRIMINALIZIMIN E POLITIKËS F. 6

EKONOMI

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS DEL ME REKOMANDIME PËR NGRITJEN E SIGURISË KIBERNETIKE F. 9

MINISTRI SHALA, APEL BIZNESEVE TË MOS IMPORTOJNË LODRA JASHTË STANDARDEVE TË BE-së F. 9

KULTURË

REVISTA E SEMINARIT NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHOQIPTARE PRANOHET NË EBSCO F. 12



SPORT

PAJAZITI: PRISHTINA E FORTË, POR TRIUMFON GJILANI F. 14

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Palmeri në Shkup për mbështetjen e marrëveshjes për emrin

SHKUP, 22 TETOR - Zëvendësndihmës-sekretari amerikan i Shtetit për Çështjet Evropiane, Matthew Palmer, ka qëndruar të hënën në Maqedoni, për t'i dhënë mbështetjen amerikane zbatimit të marrëveshjes me Greqinë për zgjidhjen e kontestit për emrin. Para ardhjes në Shkup, diplomati amerikan kishte deklaruar se "Maqedonia ka

shansin historik dhe të vetëm për të hyrë në NATO dhe BE, duke pranuar marrëveshjen me Greqinë në mënyrë institucionale". Palmer takimet i ka nisur me kryetarin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ndërsa gjatë ditës është takuar me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov dhe me kryeministrin, Zoran Zaev.

Bashkimi Demokratik për Integrim përmes një komunikate ka njoftuar se në takimin me zyrtarin e lartë amerikan "kryetari Ali Ahmeti nënvizoi përpjekjet për ta arritur përkrahjen e nevojshme në Kuvend dhe që dita e premte ishte vetëm fillimi i një procesi disamujor të zbatimit të Marrëveshjes së Prespës (Marrëveshja për emrin).

Maqedonia dhe rajoni nuk kanë alternativë tjetër përveç integrimit euroatlantik dhe miratimit të standardeve perëndimore demokratike", thuhet në komunikatë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vazhdimësi kanë mbështetur marrëveshjen me Greqinë dhe ndryshimet kushtuese, që janë të domosdoshme për zbatimin e saj.



Policëve do t'u rriten pagat mbi 100 euro

Me ligjin e ri të pagave pjesëtarëve të Policisë së Kosovës do t'u rriten pagat mbi 100 euro. Policët të ri paga do t'i rritet 105 euro, policët të lartë 129 euro, rreshterit 118 euro, togerit 124 euro, kapitenit 148 euro, majorit 69 euro dhe nënkolonelit 27 euro në muaj



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka organizuar të hënën pritje me rastin e pensionimit të policit të Kosovës, Asllan Krasniqi, pjesëtar nga Njësia për Sigurimin e Objekteve me Rëndësi të Veçantë dhe Personaliteteve (DSORVP). Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka theksuar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e kushteve për të gjithë zyrtarët policorë. Fillimisht Haradinaj ka përshëndetur Krasniqin, tashmë i pensionuar, dhe gjithë familjen e tij, duke e falënderuar atë për kontributin në shërbim të qytetarëve dhe të rendit publik. "Arsyeja që jemi mbledhur sot është të bëjmë një falënderim për shërbimin

jetësor që e ka bërë ndaj qytetarëve të vendit, të rendit publik, të të mirave të këtij populli, në këtë rast Asllanit, policit të Kosovës. Po ashtu, edhe për shkak të fajësisë që e ndiejmë pasi që polici kur shkon në pension, vërtet është një pozitë e padrejtë, pasi të ardhurat e tij përgjysmohen dhe ne ndihemi fajtorë për këtë", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se pagat e Policisë së Kosovës sipas Ligjit të ri të pagave janë ngritur në të gjitha pozitave, përfshirë këtu edhe shtesat të cilat i takojnë sipas ligjit. "Qeveria dhe institucionet e vendit kanë në konsideratë pozitën e policit, të atij që është në shërbim dhe mendoj që me paga, marrë për bazë edhe shtesat, është bërë një lëvizje e respektueshme. Ndërsa për pensionet dhe sigurimet shëndetësore tani do të punojmë

bashkë", ka thënë Haradinaj. Kryeministri Haradinaj ka prezantuar rritjet e sakta të pagave për Policinë e Kosovës sipas ligjit të ri. Sipas tij, polici i ri do të ketë rritje të pagës 105 euro nga 362 euro sa e ka tani, paga me ligjin e ri do të jetë 468 euro; polici i lartë do të ketë rritje të pagës

129 euro nga 391 euro sa e ka tani, paga me ligjin e ri do të jetë 513 euro; rreshteri do të ketë rritje të pagës 118 euro nga 440 euro sa e ka tani, paga me ligjin e ri do të jetë 558 euro; togeri do të ketë rritje të pagës 124 euro nga 509 euro sa e ka tani, paga me ligjin e ri do të jetë 634 euro; kapiteni do të

ketë rritje të pagës 148 euro nga 546 euro sa e ka tani, paga me ligjin e ri do të jetë 694 euro; majori do të ketë rritje të pagës 69 euro nga 837 euro sa e ka tani, paga me ligjin e ri do të jetë 906 euro, dhe për pozitën e nënkolonelit paga do të rritet 27 euro.

Janjiqi: Ushtria e Kosovës do të jetë pjesë e NATO-s

BEOGRAD, 22 TETOR - Kreu i Forumit për Marrëdhënie Etnike, Dushan Janjiqi, deklaroi se procesi i formimit të Ushtrisë së Kosovës nuk mund të ndalet nga Serbia, Rusia dhe Kina dhe se ky proces mund të ngadalësohet

ose të shtyhet. Në deklaratën e tij për agjencinë Beta, Janjiqi tha se pret që vetëm Rusia në seancën tjetër të Këshillit të Sigurimit të OKB-së do ta lidhë krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe largimin e UNMIK-ut si një akt të njëan-

shëm të Perëndimit, i cili do të jetë "maksimumi i mosmarrëveshjes diplomatike". "Kjo nuk i përgjigjet interesit të Rusisë, pasi është e qartë se Ushtria e Kosovës do të jetë pjesë e NATO-s, sepse tashmë po punon si një

forcë sigurie", tha Janjiqi. Sipas tij, për formimin e plotë të ushtrisë së Kosovës nevojiten prej dy deri në pesë vjet. "Serbia tani mund të bëjë zhurmë të madhe politike, sigurie dhe diplomatike, t'i thërrasë forcat paqeruajtëse ruse, ta

shpallë okupimin dhe objektivisht kjo zhurmë kërcënon me destabilizimin e Serbisë dhe tërheqjen e punës së saj në aktivitete të armatosura, që është një kufi që nuk guxon ta kalojë", tha Janjiqi.

Xhaferi për vizitë zyrtare në Republikën e Çekisë

SHKUP, 22 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, me ftesë të kryetarit të Dhomës Përfaqësuese, Radek Vondraček, po qëndron në vizitë zyrtare në Republikën e Çekisë. Kryetarin e Kuvendit e shoqëro-

jnë kryetarja e grupit parlamentar e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për Bashkëpunim me Parlamentin e Republikës së Çekisë, Jagoda Shahpanska dhe anëtarët e grupit, Vlladanka Aviroviq dhe Teuta Bilali. Në kuadër të vizitës zyrtare të

kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë janë parashikuar takime bilaterale me kreun shtetëror të Republikës së Çekisë. Kryetari Xhaferi dhe delegacioni do të realizojnë takime me kryeministrin e Republikës së

Çekisë, Andrej Babish, me kryetarin e Dhomës Përfaqësuese, Radek Vondraček, gjithashtu edhe me kryetarët e komisioneve për çështje të jashtme të Dhomës së Deputetëve në Parlamentin e Republikës së Çekisë.



Nis "Java për të drejtat e viktimave të krimit"

Kërkohet më shumë mbështetje institucionale për viktimat e krimit

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të viktimave të krimit është obligim thelbësor i sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë në Kosovë. Kështu kanë thënë drejtuesit e shtetit të hënën në konferencën "Java për të drejtat e viktimave të krimit". Me këtë rast presidenti Hashim Thaçi ka kërkuar nga gjykatësit dhe prokurorët që ta marrin seriozisht përgjegjësinë e vet ligjore ndaj viktimave



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 TETOR - Nën përkudjesjen e kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, të hënën është mbajtur dita e parë e "Javës për të drejtat e viktimave të krimit", organizim që ka mbledhur rreth vetes krerët më të lartë të shtetit. Në fjalën e tij hyrëse, kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka theksuar përkushtimin e prokurorit të Shtetit për t'i mbrojtur viktimat e krimit dhe për ta ndjekur penalisht secilin kryes të veprave penale. "Dua t'i siguroj të gjithë qytetarët e Kosovës se do të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur që viktimat e krimit të trajtohen si duhet. Kosova ka bërë përpunimin e duhur për trajtimin e dinjitetshëm të viktimave të krimit, megjithatë duhet të bëhet më shumë që këto raste ta marrin dënimin e duhur nga sistemi i drejtësisë. Inkurajoj viktimat e krimit, familjarët dhe fqinjët e tyre që ta lajmërojnë kryerjen e veprave penale dhe sa herë që është e nevojshme, të kërkojnë masa mbrojtëse që janë urgjente për ta parandaluar dhunën", ka thënë Lumezi, duke theksuar se

të drejtat e viktimave të krimit janë të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet e Kosovës dhe, si të tilla, duhet të respektohen. Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se mbrojtja e qytetarëve dhe promovimi e mbrojtja e të drejtave të viktimave të krimit është obligim thelbësor i shoqërisë, veçanërisht i sistemit të drejtësisë. "Kosova mbetet lidere në rajon edhe në fushën e të drejtave të viktimave të krimit. Ndonëse gjithmonë duhet të aspirojmë të bëjmë edhe më shumë, e vërteta është se Kosova ka treguar përkushtim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për trajtimin e viktimave të krimit", ka theksuar ai. Thaçi para të pranishmëve ka kërkuar që çdo gjykatës dhe prokuror t'i marrë përgjegjësitë e veta seriozisht. "Ligji për kompensimin e viktimave të krimit është një prej të arriturave më të mëdha në sistemin e drejtësisë. Ligji synon t'u dalë në krah individëve më të cenueshëm në shoqëri. Dhuna në familje nuk

do të lejohet në Kosovë. Është obligim i të gjithëve, veçanërisht organeve të drejtësisë, që t'i nxjerrin para drejtësisë ata që ushtrojnë dhunë dhe të mos neglizhohet asnjë rast", është shprehur ai, duke shtuar se ligji për kompensimin e viktimave të krimit dhe krijimi i mekanizmeve përkatës që janë të nevojshëm për zbatimin e këtij ligji është një prej të arriturave më të mëdha në sistemin e drejtësisë në Kosovë. "Ligji synon t'u dalë në krah individëve më të cenueshëm në shoqëri, grave, fëmijëve dhe viktimave të trafikimit", ka theksuar Thaçi. Kreu i shtetit ka thënë se dhuna në familja nuk do të lejohet në Kosovë. "Është obligim, në veçanti i organeve të drejtësisë, që t'i nxjerrin para drejtësisë të gjithë ata që ushtrojnë dhunë, duke mos neglizhuar asnjë rast. Por, edhe të siguroj trajtim të dinjitetshëm dhe kompensim për viktimat e krimit", ka deklaruar Thaçi. Edhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se

Kosova ka legjislacion të avancuar në parandalimin dhe ndëshkimin e krimit. "Përderisa Kosova është vendi i parë në rajon që ka ndërtuar mekanizmat e duhur institucionalë, mund të konfirmoj se nga viti në vit po rregullohet sistemi që garanton të drejtat e viktimave", ka deklaruar Tahiri, duke shprehur përkushtimin që të kontribuojë për krijimin e kushteve sa më të mira për drejtësinë që t'u vihet në ndihmë viktimave. Kurse kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka potencuar detyrimin e gjyqtarit që trajton rastet me viktimat, që t'i mbrojë ato duke shqiptuar dënim meritore për secilin shkelës të të drejtave të njeriut. Ndërkaq ushtruesja e detyrës së ambasadores së ShBA-së në Prishtinë, Colleen E. Hyland, ka theksuar se Ambasada e ShBA-së ka kontribuar në mënyrë domethënëse për parandalimin e dhunës në familje në Kosovë. "Kemi kërkuar që dhuna në familje të trajtohet si kategori

prioritare. Ambasada e ShBA-së përmes programeve të veta ka ndihmuar institucionet e Kosovës që ta përmirësojnë përgjigjen ndaj rasteve të dhunës në familje. Mbështetja ndaj viktimave duhet të jetë në qendër të vëmendjes suaj. Këtë vit Kosova ka parë vrasje tragjike si pasojë e dhunës në familje. Është e qartë që secili duhet të alarmohet nga këto raste dhe të inkurajohen viktimat që t'i paraqesin këto raste, dhe jo t'i fshehin ato nga turpi", ka deklaruar Hyland. Ndërkaq Cezary Michalczuk nga Zyra e BE-së në Kosovë ka shprehur kënaqësinë që e drejta në Kosovë po zbatohet sipas standardeve ndërkombëtare, por ka kërkuar që reforma në gjyqësor të begatohet me ndryshimet e tanishme në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale. Ndërsa kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufi, ka theksuar përkushtimin e KPK-së, për t'i siguruar mekanizmat e nevojshëm në luftimin e krimit dhe mbrojtjen e viktimave.

BE-ja nuk ka datë për vazhdimin e dialogut, procesi mbetet i 'ngrirë'



PRISHTINË, 22 TETOR - Bashkimi Evropian nuk e ka përcaktuar ende datën e vazhdimin të dialogut në Bruksel ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit qoftë për negociatat në nivelin politik apo për bisedimet në nivelin teknik. Sipas zyrtarëve të Bashkimit Evropian, puna rreth caktimit të takimit dhe temave të ardhshme është duke vazhduar. "Puna është duke vazhd-

uar në nivelin teknik, përkritazi me takimin e lartë të ardhshëm të dialogut, data e të cilit pritet të konfirmohet", ka thënë në një përgjigje me shkrim për "Radion Evropa e Lirë", Maja Kocijançiq, zëdhënëse e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherinit. Nisur nga historia e takimeve të fundit, si në nivelin e presiden-

tëve, po ashtu edhe në atë teknik, Beogradi nuk ka pranuar të ulet dhe të bisedojë me palën nga Kosova. Më 7 shtator presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kishte refuzuar takimin me homologun nga Kosova, Hashim Thaçi, pasi që autoritetet e Prishtinës atëkohë fillimisht nuk i kishin lejuar atij ta vizitonte liqenin e Ujmanit në veri të Kosovës.



Tranzicioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të bëjë që kjo forcë ta shtojë numrin e pjesëtarëve të saj

Ushtria e Kosovës do

Transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri nuk do ta ndryshojë vetëm misionin kësaj force, por edhe numrin e pjesëtarëve të saj. Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se kjo forcë do t'i ketë 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë. "Do të ketë rritje qind për qind. Dhe rekrutimi i parë do të jetë në fillim të vitit të ardhshëm", ka thënë gjeneralletenant Rama. Po të hënën edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se me formimin e ushtrisë do të shtohet nevoja për rekrutimin e pjesëtarëve të ri në këtë forcë

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 TETOR - Me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të rritet edhe numri i pjesëtarëve të kësaj force. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë deklaruar se ushtria e Kosovës do t'i ketë 8 000 pjesëtarë, 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë. "FSK-ja do të jetë forcë ushtarake shumënike dhe e armatosur. Forca e Sigurisë së Kosovës do t'i ketë 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë. Pra, do të ketë rritje qind për qind. Rekrutimi i parë do të jetë në fillim të vitit të ardhshëm. Varësisht prej

zhvillimeve do të ketë rritje të forcës", ka thënë për gazetën "Epoka e re" gjeneralletenant Rrahman Rama.

Ai ka treguar se me miratimin e pakos së projektligjeve për transformimin e FSK-së, misioni i kësaj force ndryshon në mision ushtarak. "Kompetencat e Forcës së Sigurisë së Kosovës do të jenë të njëjta me ato të ushtrive moderne të shteteve demokratike. FSK-ja do ta ketë për mision mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës, por edhe obligimet e tjera që dalin varësisht prej nevojave që i kanë autoritetet civile. Ne jemi nën kontrollin civil demokratik dhe të gjitha obligimet, detyrat dhe nevojat që dalin prej institucioneve dhe qytetarëve, do ta kenë përkrahjen e FSK-së", ka theksuar

ai.

Po të hënën edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se me formimin e ushtrisë do të shtohet nevoja për rekrutimin e pjesëtarëve të ri në këtë forcë. Sipas tij, ushtria e Kosovës do të jetë garanci edhe për rajonin. "Jo vetëm Kosova, por edhe rajoni ynë do të përfitojnë nga tranzicioni i FSK-së, pasi zhvillimi i një ushtrie të vogël shumënike dhe profesionale do ta rrisë sigurinë dhe stabilitetin rajonal, ta shmangë mundësinë e ndonjë vakuumi të sigurisë në Kosovë dhe të kontribuojë në përafrimin e vendit tonë me vlerat euroatlantike, ta lehtësojë kalimin e Republikës sonë nga një konsumator i sigurisë te një ofrues i saj, duke i përfaqësuar dhe



Presidenti pret ekipin e FSK-së që fitoi medaljen e bronzë

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të hënë ka pritur ekipin e Forcës së Sigurisë së Kosovës që ka marrë pjesë në garën "Cambrian Patrol" në Britani të Madhe, ku ka fituar medaljen e bronzë.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar komandantin Rrahman Rama dhe ekipin e Forcës së Sigurisë së Kosovës për punën e mrekulueshme që po bëjnë, duke u bërë shembull i mirë për tërë rajonin. "Gjenerali dhe ekipi i tij, me këta eprorë e ushtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, janë shembulli dhe mesazhi më i mirë që po dërgohet, se FSK-ja është e gatshme për përgjegjësi shtesë. Është e gatshme t'u përgjigjet rrethanave dhe situatave të reja të krijuara. I përgëzoj eprorët, togerët, ushtarët e FSK-së dhe

komandantin për punën e tyre shumë të mirë, por edhe për suksesin e ri, të shkëlqyer që e kanë arritur ditë më parë me pjesëmarrjen e tyre në garën në Britani, ku kanë marrë pjesë 144 ekipe", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama, ka thënë se kjo është një prej garave më prestigjioze në botë dhe Forca e Sigurisë së Kosovës po merr pjesë për herë të dytë. "Është shumë me rëndësi që këto përvoja po i bartim edhe brendapërbrenda institucionit tonë. Edhe në vitin e kaluar e kemi organizuar një kesi gare të cilën e kemi quajtur 'Shqiponja patrulluese'. Ideja ka qenë që ta bëjmë një test të brendshëm, me qëllim dhe synim që vitin e ardhshëm ta bëjmë vetë një garë që do të jetë

ndërkombëtare, me të gjitha ato përvoja që i kemi marrë prej Mbretërisë së Bashkuar", ka thënë komandanti Rama.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës ka thënë se janë të gatshëm të marrin përgjegjësi shtesë dhe do ta vazhdojnë kryerjen e obligimeve dhe detyrave që u caktohen me ligj dhe Kushtetutë. Gara e "Cambrian Patrol" është një ngjarje vjetore e organizuar dhe drejtuar nga Brigada e Këmbësorisë së 160 dhe Selia e Uellsit, me seli në Brecon të Britanisë së Madhe.

Forca e Sigurisë së Kosovës këtë vit ka marrë pjesë me 11 pjesëtarë në këtë garë ndërkombëtare dhe, pavarësisht prej vështirësive të krijuara nga stuhia "Cullum", ka arritur ta fitojë Medaljen e Bronzë.



t'i ketë 8 000 ushtarë

mbështetur të gjitha komunitetet e Kosovës, të lejojë angazhim më të madh dhe bashkëpunim me KFOR-in dhe NATO-n, por edhe ta forcojë ekonominë tonë. Kjo iniciativë do të krijojë 2 500 vende të reja pune", ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka vlerësuar se me transformimin e FSK-së në ushtri Kosova po e ndërton arkitekturën e vet të sigurisë. "Tranzicioni i FSK-së po tregon rrugën e qartë dhe angazhimin e Kosovës drejt konsolidimit të shtetësisë, konsolidimit të arkitekturës së sigurisë kombëtare, si dhe kontributin rajonal për stabilitet dhe siguri", është shprehur Haradinaj në një ligjëratë në Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK), ku temë e diskutimit me studentët

ishte transformimi i FSK-së.

Ushtria e Kosovës do të jetë pjesë e NATO-s

Komandanti i FSK-së, kryeministri dhe ekspertët ushtarakë kanë bërë me dije se transformimi i FSK-së në ushtri përmes ligjeve nuk parqet ndonjë pengesë që kjo forcë në të ardhmen të bëhet pjesë e NATO-s. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka deklaruar për gazetën se, pas transformimit, synimi kryesor i kësaj force është anëtarësimi në NATO. "NATO-ja sa është organizatë ushtarakë është edhe politike. Nuk shoh ndonjë problem sa i përket anëtarësimi të FSK-së në

NATO. Ky është qëllimi ynë kryesor. Mirëpo duhet ta kuptojmë se ky është edhe proces politik dhe nuk varet vetëm prej nesh. Synimi ynë kryesor është që të jemi pjesë e strukturave euroatlantike. FSK-ja do ta vazhdojë zhvillimin dhe punën në shërbim të qytetarëve dhe të vendit", ka deklaruar Rama. Edhe ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, ka deklaruar për "Epokën e re" se në NATO anëtarësohen vetëm organizatat ushtarake. "NATO-ja nuk pranon organizata për shkak të emrit, por pranon organizata me mision ushtarak. Kjo mënyrë e transformimit të FSK-së nuk do të sjellë asnjë pengesë që kjo forcë të ecë drejt integritimit në NATO. Në përgjithësi kjo forcë do të trajnohet dhe

shkollohet me standardet më të larta të NATO-s. Gjithashtu, do të jetë e armatosur sipas standardeve të NATO-s. Në këtë mënyrë nuk do të kemi asnjë problem të marrim pjesë në operacione paqeruajtëse apo luftarake në kuadër të NATO-s", ka thënë Kastrati.

Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka shpjeguar se transformimi i FSK-së i hap rrugë integritimit të kësaj force drejt NATO-s. "Ishte një proces, jo një vendim i izoluar. Ky proces transparent e përgatitë Kosovën për rrugën e saj drejt anëtarësimi në NATO dhe i hap rrugë që të kontribuojë më tej drejt paqes dhe stabilitetit nëpërmjet operacioneve të mbajtjes së paqes", është shprehur Haradinaj para studentëve të Universitetit

Amerikan në Kosovë, ku të pranishëm ishin edhe kadetët e FSK-së. Kreu i ekzekutivit është shprehur i bindur se Kosova do të bashkohet me NATO-n në vitet e ardhshme dhe prania e Aleancës Veri-Atlantike në Kosovë do të jetë e mirëpritur përgjithmonë. "Ndërtimi i FSK-së dhe tranzicioni i saj është jetësor për ta vazhduar zhvillimin e bazuar në standardet e ShBA-së dhe NATO-s në doktrinën, udhëheqjen, sistemin e armëve dhe pajisjet", ka vlerësuar kryeministri Haradinaj, duke thënë se ndërtimi i kapaciteteve të plota do të zgjasë rreth dhjetë vjet dhe do të ndahet në tri faza. Kuvendi i Kosovës javën e kaluar ka votuar tri projektligje për transformimin e FSK-së, ku parashihet edhe krijimi i Ministrisë së Mbrojtjes.

Të mërkurën promovohet libri 'Nëna ime Mihane Lama' i autorit Kudusi Lama


"Kjo vepër e Kudusi Lamës është me ndikim të veçantë pedagogjik dhe duhet të lexohet e rilexohet, sepse lexuesi shqiptar sot ka nevojë për libra të këtillë", ka shkruar Rexhep Qosja në parathënien e këtij libri.

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 TETOR - Gjenerali i mirënjohur i luftës së Kosovës, Kudusi Lama, javë më parë e nxori nga botim një libër të veçantë në përvojën e tij profesionale - një monografi kushtuar nënës së vet, Mihane Lama. Promovimi i librit "Nëna ime Mihane Lama" do të bëhet më 24 tetor në Institutin Albanologjik të Prishtinës në orën 12:00. Ky libër i rrallë, i shkruar nga një ushtarak karriere e gjeneral lufte, habit lexuesin për ndjeshmërinë që bartë, sidomos për kulturën e shkrimit. Dr. Kudusi Lama rrëfen jetën e nënës së vet

(Mihane Lama), e cila i kishte rritur me vuajtje dhe sakrificë shumë të mëdha dy fëmijët e saj të mbetur pa baba që në vegjëli të hershme (të cilët më vonë u bënë ushtarakë me nam). Akademik Rexhep Qosja e ka vlerësuar të veçantë e me vlerë librin e Kudusi Lamës jo vetëm për përmbajtjen dhe përshkrimin e protagonistes, por edhe për faktin se ai është shkruar me një mjeshtri të rrallë nga një gjeneral. "Kjo vepër e Kudusi Lamës është me ndikim të veçantë pedagogjik dhe duhet të lexohet e rilexohet, sepse lexuesi shqiptar sot ka nevojë për libra të këtillë", ka shkruar Rexhep Qosja në parathënien e këtij libri.

Edhe prof. dr. Emil Lafe ka shkruar se duke rrëfyer për nënën Mihane, Kudusi Lama e sjellë të gjallë jo vetëm figurën e nënës, por edhe një botë dhe një epokë. "Ky libër nuk është thjesht një shprehje dashurie e një peng nderimi për nënën, por edhe një histori njerëzore e shoqërore me përmasa të një romani shumëplanësh", ka shkruar Emil Lafe. Kudusi Lama është autor i disa librave nga fusha e studimeve ushtarake dhe të sigurisë por, ai, gjithashtu, ka botuar edhe disa libra publicistikë. Karrierën profesionale e ka ndërtuar si oficer në Ushtrinë e Shqipërisë deri në gradën e gjeneralit.



IKD-ja kërkon dekriminalizimin e politikës

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka mbajtur të hënën në Prishtinë tryezën "Si të parandalohet dhe luftohet kriminalizimi i politikës në Kosovë: Zgjidhja përmes rregullimit ligjor apo kodit të etikës?", si aktivitet i projektit "Rritja e pjesëmarrjes qytetare në proceset zgjedhore në Kosovë" në kuadër të Koalicionit për Integritet Zgjedhor (KIZ).

Në këtë tryezë është publikuar raporti i IKD-së mbi zbatueshmërinë e procedurave standarde të veprimit, në kuadër të organizimit të zgjedhjeve në Kosovë me titull "Dekriminalizimi i politikës në Kosovë".

Pjesë e panelit të kësaj tryeze kanë qenë përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ai i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Sejdiu, përfaqësuesi i Nismës



Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ai i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, përfaqësuesi i Alternativës, Hasan Preteni, ai i Aleancës Kosova e Re (AKR), Vesel Makolli dhe drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Ehat

Miftaraj. Në tryezë është thënë se sundimi i ligjit vazhdon të mbetet halka më e dobët në zinxhirin e shtetndërtimit dhe qeverisjes në Kosovë. IKD-ja ka vlerësuar se institucionet përkatëse, e sidomos

prokuroria e gjyqësori, janë duke u përballur me probleme sistematike e të përsëritshme, një prej të cilave vazhdon të mbetet ndërhyrja politike. "Dhe përkundër të gjithë problemeve të sistemit të drejtësisë, pra duke marrë për bazë veç ato pak raste

që ky sistem i trajton, fare lehtë krijohet përshtypja se krimi dhe politika bashkëjetojnë në Kosovë. Rastet kur zyrtarët e lartë të shtetit, ditën e punës e fillojnë në gjykatë, në cilësinë e të pandehurit, përpara se të vazhdojnë ta qeverisin vendin, nuk janë të rralla. Aktualisht janë shtatë ministra të cilët kanë aktakuza, për të cilat po zhvillohen procedura gjyqësore në gjykata, kryesisht për vepra penale të korrupsionit", është thënë në njoftimin e IKD-së. Ky institut ka listuar disa nga rastet ku politikanët kanë qenë të përfshirë në vepra të ndryshme penale.

Në këtë drejtim IKD-ja ka vlerësuar se kriminalizimi i skenës politike në Kosovë është bërë veçanërisht në Kosovë, veçanërisht që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, duke u shndërruar në një 'standard' të qeverisjes.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit, vizitë në Prokurori

PRIZREN, 22 TETOR (ER) - Prokurorinë Themelore në Prizren e vizituan fëmijët nga Asambleja Komunale e Fëmijëve, e cila udhëhiqet nga OJQ "Nevo Koncepti" në Prizren. Gjatë këtij takimi zëvendëskryeprokurorja Arijana Shajkocvi i ka njoftuar fëmijët për funksionimin dhe efikasitetin e prokurorisë, veçanërisht për funksionimin dhe organizimin e Departamentit për të Mitur. Shajkocvi ka prezantuar

angazhimin e organit të Prokurorisë për trajtimin e veçantë që bëhet në rastet ku të përfshirë në vepra penale janë personat nën moshën 18 vjeç. Pas prezantimit fillestar, vijoi diskutimi i hapur me fëmijët asamblistë. Një nga pikat për të cilën u interesuan më shumë fëmijët ishte informimi me procedurën e raportimit të rasteve në institucionet e ndjekjes, kur fëmijët janë të dëmtuar apo përfshirë në rastet e veprave penale.

Çështje të tjera që u diskutuan ishin edhe liritë dhe të drejtat e fëmijëve, kohëzgjatja e dënimit më burg për të mitur, martesat e hershme dhe bashkëjetesa nën moshën 16-vjeçare etj. Prokuroria Themelore në Prizren, si institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese, mbetet e përkushtuar dhe e zotuar që vazhdimisht të punohet, që të promovohen dhe të mbrohen liritë dhe të drejtat e fëmijëve.



Gjykata Supreme përsëri bllokon lirimin e Sylejman Selimit

Avokati Tomë Gashi ka thënë se Gjykata Supreme e Kosovës përsëri ka bllokuar lirimin e Sylejman Selimit. Sipas tij, mbajtja në paraburgim e klientit të tij është politike dhe jologjore. "Për mbajtjen e kundërligjshme të Sylejman Selimit në burg është duke u përgatitur një kallëzim penal kundër të gjithë përgjegjësve që do të identifikohen për këtë skandal të qëllimshëm juridik me prapavijë politike", ka thënë avokati Gashi

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 TETOR - Avokati Tomë Gashi ka bërë me dije të hënën se Gjykata Supreme e Kosovës përsëri ka bllokuar lirimin e Sylejman Selimit. Njëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka

shkruar se që nga 11. 6. 2018 gjeneral Sylejman Selimi është duke u mbajtur në burgun e Dubravës pa asnjë të drejtë. "Për këtë nuk ka asnjë arsye ligjore, përveç arsyeve 'të fshehta' që eventualisht 'mund t'i dijë' apo 't'i ketë shpikur' vetë gjykata më e lartë në Republikën e Kosovës për ta mbajtur atë në mënyrë të



kundërligjshme në burg. Arsye ligjore nuk ka as për ta bllokuar lirimin me kusht të Sylejman Selimit, që këtë herë e bëri paneli për lirimin me kusht, duke kërkuar informacione nga Gjykata Supreme të cilat në avokatët e Sylejman Selimit jemi duke i kërkuar për më tepër se 133 ditë", ka shkruar Gashi.

Ai ka theksuar se është më se e qartë se janë arsye politike dhe jologjore për mbajtjen e gjeneral Sylejman Selimit në burg në mënyrë të kundërligjshme. "Ata që po e mbajnë duhet të mendojnë për vetveten sepse një ditë do të përballen me forcën e ligjit. Për mbajtjen e kundërligjshme të Sylejman Selimit në burg është duke u përgatitur një kallëzim penal kundër të gjithë përgjegjësve që do të identifikohen për këtë skandal të qëllimshëm juridik me prapavijë politike. Gjeneral Sylejman Selimi nuk besoj se ka luftuar për kesi sistemi juridik të

Kosovës ku pasiguria juridike qëllimisht është duke u krijuar edhe ndaj vetë komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së", ka thënë avokati i Sylejman Selimit, Tomë Gashi.

OVLUÇK-ja: S'ka bazë juridike që Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku të mbahen në burg


Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së konsideron se për rastin Drenica 1 dhe Drenica 2 nuk ka asnjë bazë juridike që Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku të mbahen në burg. "Për shumë vite pas luftës ishim dëshmitarë të dështimit total të drejtësisë ndërkombëtare e cila përmes mekanizmave të ashtuquajtur të drejtësisë, vazhdimisht organizoi komplete kundër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe në rastin Drenica 1 dhe 2 nuk ka asnjë bazë juridike që Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku të mbahen në burg. Sjellja e sistemit të drejtësisë ndaj tyre është veprim i pastër politik dhe degradues për sistemin e drejtësisë në Kosovë", është thënë në reagimin e OVLUÇK-së. Sipas OVLUÇK-së, gjatë gjithë gjyqimit ndaj tyre janë bërë padrejtësi. "Po të kishim gjyqësi të mirëfilltë, duhet të ndiqeshin penalisht të gjithë ata që pa asnjë bazë juridike po i mbajnë në burg bashkëluftëtarët tanë. Me këto veprime po dëshmohet edhe një herë, si shumë herë të tjera, se drejtësia ndërkombëtare vetëm ka përndjekur luftëtarët e UÇK-së", është theksuar në reagimin e OVLUÇK-së.



Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare pranohet në EBSCO

Prishtinë, 22 tetor (ER) - Pak më shumë se një vit pas marrjes së numrit ISSN, revista e seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është pranuar në njërin nga platformat më prestigjioze të revistave shkencore EBSCO. Kjo u bë e mundur falë angazhimit vetëmohues të dekanes Lindita Rugova dhe për shkak të cilësisë që e ka revista e institucionit më të madh dhe me më traditë të shkencave albanologjike. "Një lajm për t'u mbajtur mend. Sapo më erdhi email-i zyrtar me marrëveshjen bashkëngjitur, ku konfirmohet se revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është pranuar nga bordi i platformës EBSCO që të

përfshihet zyrtarisht në të. Pas konkurrimit në qershor 2018, në gusht më njoftuan se e kemi kaluar pozitivisht recensionin ndërkombëtar e tash jemi përfshirë në të. Dua të theksoj se kjo është një e arritur shumë e madhe e Fakultetit të Filologjisë sepse mund të jetë (nuk jam 100 për qind e sigurt) revista e parë shkencore nga Kosova, natyrisht, në bashkëpunim me Fakultetin Histori - Filologji në Tiranë, nga shkencat filologjike që është pranuar në këtë platformë. Urime atyre që me kontributin e tyre e kanë themeluar këtë revistë, atyre që kanë dhënë djersë e mund për ta mbajtur gjallë dhe atyre që e kanë përkrahur gjithmonë dhe kanë besuar në të!", ka shkruar Lindita Rugova në llogarinë e vet në "Facebook".





Bytyqi dhe përfaqësuesit e FMN-së diskutojnë për mësimdhënësit e viteve '90

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të hënën në takim një ekip të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i prirë nga Stephanie Eble, shefe e Misionit për Kosovë, me të cilët ka biseduar rreth gjendjes në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, për reformat, për çështjet buxhetore, si dhe për Ligjin për mësimdhënësit e viteve '90. Ministri Bytyqi me këtë rast ka falënderuar përfaqësuesit FMN-së për mbështetjen e vazhdueshme si dhe për interesimin që të kemi përparim në sistemin e arsimit në Kosovë. Ai ka thënë se si MASHT janë të angazhuar për zbatimin e reformave në mënyrë që ta

ngrehin cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet. Ministri Bytyqi ka thënë se me gjithë rritjen e buxhetit ende nuk mjafton të zbatohet plotësisht PSAK-u dhe ka shtuar se mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë është më se e nevojshme.

Ministri Bytyqi foli për gjendjen në edukimin parashkollor në nivelin 0-5 vjeç dhe tha se përfshirja e fëmijëve në këtë nivel nuk është e kënaqshme dhe se gjasat për përfshirje 95 për qind janë larg mundësive tona aktualisht.

Ministri ka theksuar se në këtë drejtim po punohet me disa partnerë ndërkombëtarë që të gjenden zgjidhje të tjera për përfshirje më të madhe të fëmijëve në këtë nivel.

Sa i përket arsimit profesional,

ministri Bytyqi ka pohuar se është i angazhuar që të rritet shkalla e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit për zbatimin e mësimin praktik dhe se është duke u hartuar kurrikula bërthamë dhe standardet e profesioneve.

Bytyqi dhe përfaqësuesit e FMN-së folën edhe për Ligjin për mësimdhënësit e viteve të '90, për koston e implementimit të tij, si dhe për mundësitë e implikimeve anësore të këtij ligji. Lidhur me këtë, ministri Bytyqi ka thënë se është diskutuar disa herë edhe me deputetët në Komisionin Parlamentar për Arsim dhe versionin i parë ka pësuar disa ndryshime dhe pritet të ketë ndikim më të arsyeshëm buxhetor në zbatimin e tij.

Bahtiri kërcënohet me vdekje, shkak hapja e urës mbi Ibër

MITROVICË, 22 TETOR (ER) - Në adresën elektronike të Komunës së Mitrovicës ka arritur një letër kërcënuese drejtuar kryetarit të komunës, Agim Bahtiri. Në letërën e shkruar në gjuhën angleze, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, kërcënohet me vdekje për shkak të angazhimit dhe insistimit të tij të vazhdueshëm për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër. "Kërcënuesit kërkojnë nga kryetari Bahtiri që të mos ndërmarrë asnjë veprim për hapjen e kësaj ure, edhe pse projekti i BE-së për rivitalizimin e saj ka përfunduar në tërësi. Për rastin e kërcënimit të kryetarit Bahtiri është njoftuar policia e Kosovës dhe institucionet e tjera përkatëse, të cilat janë duke u marrë me këtë çështje", ka njoftuar Komuna e Mitrovicës. Bahtiri ka njoftuar qytetarët e komunës dhe opinionin e gjerë, se kërcënimet e këtilla dhe asgjë tjetër, nuk mund të ndalin në

asnjë mënyrë angazhimin dhe përkushtimin e tij për paqe, tolerancë dhe për stabilizimin e plotë të gjendjes në Mitrovicë, që nënkupton edhe hapjen sa më të shpejtë të urës kryesore mbi lumin Ibër për lëvizje e qarkullim të lirë të njerëzve dhe automjeteve në të dyja drejtimet të qytetit. Po ashtu, kryetari Bahtiri ka kërkuar nga qytetarët të mos dekurajohen nga ky veprim qyqar i individëve apo grupeve kriminale që nuk duan përmirësim të gjendjes në qytetin e Mitrovicës e as përmirësim të raporteve ndëretnike e të bashkëpunimit midis qytetarëve të të dy komunave. "Unë kërkoj nga qytetarët e Mitrovicës, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, që të jenë të qetë e të përkushtuar për t'i çuar përpara proceset e stabilizimit të plotë të situatës politike e të sigurisë dhe të zhvillimit ekonomik në qytetin e Mitrovicës", ka thënë kryetari Bahtiri.



Shefja e Zyrës e BE-së viziton ministrin e ri të Punëve të Brendshme

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pritur të hënën në takim njoftues shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian/Përfaqësuesen e Posaçme të BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova.



Në këtë takim ministri Mustafa e ka njoftuar Apostolovën me prioritet e tij dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku vuri në pah se luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit do të jenë prioritetet kryesore të punës së tij. Gjithashtu, ministri Mustafa ka theksuar se MPB-ja është e përkushtuar për ta avancuar bashkëpunimin me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe për vazhdimin

e angazhimeve për menaxhimin e procesit pas liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ndërsa Nataliya Apostolova, pasi e ka uruar ministrin Mustafa për detyrën e re, ka thënë se Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar për fuqizimin e bashkëpunimit me institucionet e sigurisë dhe se është e gatshme ta ndihmojë Kosovën për plotësimin e kushteve në procesin e integritimit evropian.



Zyrtarët e LDK-së njoftojnë anëtarët e CDU-së për zhvillimet në Kosovë

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Kryetari i Grupit Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në takim anëtarët nga CDU, Ulrich Beul, David A. Lungen, Silvio Crapis dhe Besnik Kelmendi.

Në këtë takim u diskutua për zhvillimet e fundit politike në Kosovë, për proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë dhe sfidat e tij

të brendshme. Hoti ka njoftuar anëtarët e CDU-së rreth qëndrimeve të LDK-së si parti opozitare në Kuvendin e Kosovës dhe ka vlerësuar lart mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë për shtetin e Kosovës, duke theksuar rëndësinë që kjo mbështetje të vazhdojë edhe në të ardhmen. Gjithashtu, ai ka vlerësuar edhe bashkëpunim që ka LDK-ja me CDU-në dhe i ka falënderuar ata

për mbështetjen e vazhdueshme të cilën e japin përmes Fondacionit KAS. Ndërsa anëtarët e CDU-së falënderuan kryetarin e grupit të LDK-së për pritjen, duke vlerësuar rolin e LDK-së në proceset zhvillimore nëpër të cilat po kalon shteti i Kosovës, si dhe konfirmuan përkrahjen e shtetit gjerman për Kosovën në rrugëtimin e saj drejt integritimit evropian.

Shoqata e Bankave të Kosovës del me rekomandime për ngritjen e sigurisë kibernetike

Shoqata e Bankave të Kosovës ka njoftuar bizneset dhe qytetarët për disa nga rekomandimet për ngritjen e sigurisë kibernetike. Ky njoftim ka ardhur në kuadër të muajit botëror për sigurinë kibernetike



kartela; Mos shkarkoni aplikacione nga ndonjë media përveç tregjeve të aplikacioneve që ofron pajisja juaj e telefonit mobil; Në ditët e sotme, është shumë e rëndësishme që detajet e Bankës së përfuturës të pranohen në mënyrën më të sigurt për t'i ekzekutuar pagesat me qëllim të shmangies së rrezikut të pagesave të falsifikuara", është thënë në këtë njoftim.

Shoqata e Bankave të Kosovës ka theksuar se në këtë kontekst bizneset duhet t'i kontrollojnë dhe verifikojnë llogaritë e pagueshme të furnitorëve dhe, po ashtu, duhet ta marrin faturën origjinale para ekzekutimit të pagesave. "E fundit, por jo më pak e rëndësishme, për të arritur te ju, sigurohuni që informatat tuaja të telefonit dhe e-mail-it të ruajtura në sistemin bankar janë gjithmonë të përditësuara.

Si përfundim, ju inkurajojmë që nëse eventualisht hasni në diçka të tillë apo jeni në dijeni se është duke u tentuar të kryhet vepra, ta raportoni rastin në Policinë e Kosovës ku do të drejtoheni te Njësia për Luftimin e Krimeve Kibernetike", është thënë në njoftimin e Shoqatës së Bankave të Kosovës.

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 22 TETOR - Në kuadër të muajit botëror për sigurinë kibernetike, Shoqata e Bankave të Kosovës ka njoftuar bizneset dhe qytetarët për disa nga rekomandimet për ngritjen e sigurisë kibernetike. Me zhvillimin e teknologjisë informative dhe shërbimeve digjitale, edhe mbrojtja nga sulmet kibernetike bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Sulmet kibernetike nuk kursejnë as Kosovën, në veçanti cenojnë bizneset dhe institucionet e ndryshme. "Mashttrimet përmes sistemeve kompjuterike mund të shkaktojnë dëme të konsiderueshme, prandaj Shoqata e Bankave të Kosovës paraqet disa rekomandime për bizneset në mënyrë që të mbrohen më mirë nga sulmet kibernetike", është thënë në njoftimin për media të

Shoqatës së Bankave të Kosovës. Sipas këtij njoftimi, për ta rritur sigurinë kibernetike Shoqata e Bankave të Kosovës ka rekomanduar që bizneset dhe organizatat e ndryshme të marrin këto masa. "Të sigurojnë sistemet kompjuterike me antivirus - rekomandohet që sistemin operativ ta mbani rregullisht të azhurnuar me përditësimet e fundit, po ashtu patjetër të keni të instaluar antivirus dhe atë ta mbani rregullisht të azhurnuar. Gjithashtu, edhe aplikacionet e tjera siç janë shfletuesit (Explorer, Firefox, Chrome) t'i mbani të përditësuar; Të mos hapen e-mail të dyshimtë apo që nuk iu dihet dërguesi, edhe nëse vërtet keni pranuar një e-mail nga ndonjë burim i besueshëm dhe atë e-mail nuk keni qenë duke e pritur, rekomandohet që paraprakisht ta kontaktoni dërguesin dhe ta pyesni nëse vërtet është ai dërguesi i e-mailit, ngaqë ndodh që e-maili i dërguesit është komprometuar dhe

mashtuesit/hakerët përdorin atë e-mail për mashtrimin e të tjerëve; Mos klikoni linkun që vjen në e-mail; shkruani ueb adresën e institucionit që dëshironi ta vizitoni në internet në adresën e 'browser'-it tuaj; Mos e hapni dokumentin/et e bashkëngjitur në e-mail që dërgohet nga dërguesit e panjohur ose që përmban ndonjë dosje të cilën ju nuk e prisni", është theksuar në njoftimin e Shoqatës së Bankave të Kosovës.

Me tej është thënë se nuk duhet të dërgohen informatat personale, në veçanti emrin e përdoruesit,

fjalëkalimin dhe informatat e kredit kartelës përmes e-mailit, mesazheve të mediave sociale ('Facebook' etj.). "Bizneset e ligjshme, sidomos bankat, nuk do t'u kërkojnë përdoruesve të dërgojnë informatat e tyre personale të ndjeshme përmes këtyre mjeteve. Mos kryeni transaksione bankare në kompjuterë të cilëve ju nuk u besoni. Mos përdorni Wi-Fi (lidhje publike të internetit) kur kryeni ndonjë çështje financiare. Përdorni rrjeta të sigurta Wi-Fi ose 3G për çdo transaksion të sigurt si e-banking dhe transaksione 'online' me

Lluka me përfaqësuesin e qeverisë gjermane diskuton për Telekomin dhe termocentralin 'Kosova e Re'



A. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 TETOR - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur të hënën në takim koordinatorin përgjegjës të qeverisë gjermane për çështje dhe marrëdhënie transatlantike, njëherësh anëtar i Komitetit të Punëve të Jashtme, Peter Beyer, me të cilin kanë diskutuar rreth ndërmarrjeve publike, me theks të veçantë Telekomin e Kosovës dhe termocentralin "Kosova e Re".

Ministri Lluka gjatë takimit e njoftoi Beyerin rreth gjendjes aktuale të ndërmarrjeve publike qendrore, për

reformat të cilat janë ndërmarrë dhe synimet e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Telekomit të Kosovës. "Qeveria e Kosovës, veçanërisht MZHE, duke parë gjendjen e Telekomit të Kosovës, është duke u munduar që brenda dy vjetëve ta privatizojë atë dhe ta kthejë në gjendje fitimprurëse. Ndërsa për sa iu përket ndërmarrjeve publike qendrore në përgjithësi, janë ndërmarrë reforma si dhe është miratuar projektligji i ri, i cili, ndër të tjera, synon ta përmirësojë funksionimin e tyre", ka thënë ministri Lluka.

Ai e ka informuar Peter Beyerin rreth ndërtimit të termocentralit

"Kosova e Re", për rëndësinë jetike që ka për bizneset vendore si dhe për punën që është duke u bërë në projektet e energjisë së ripërtrishme, ku deri në vitin 2020 pritet të arrihet synimi që 25 për qind e energjisë së prodhuar të jetë nga energjia e ripërtrishme.

Po ashtu, u nda edhe një shqetësim ku, si pasojë e moszbatimit të marrëveshjes së interkoneksionit me Serbinë, ka humbje të mëdha në sektorin e energjisë.

Ministri Lluka ka kërkuar përkrahje nga Beyer për implementimin e kësaj marrëveshjeje të cilën e ka konsideruar jetike për bizneset dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

Ministri Shala, apel bizneseve të mos importojnë lodra jashtë standardeve të BE-së

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se shumë shpejt do të asgjësohen lodrat e konfiskuara që pas analizave në Holandë kanë dalë të jenë jashtë standardeve. Shala ka apeluar te tregtarët që t'i importojnë lodrat që janë me standarde të Bashkimit Evropian dhe nuk janë të dëmshme për shëndetin e fëmijëve. "Ne kemi marrë masat dhe i kemi bllokuar të gjitha sasitë e lodrave që kanë rezultuar si të dëmshme. Ne jemi duke pritur leje mjedisore nga Ministria e Ambientit dhe shumë

shpejt do ta marr vendimin për asgjësimin e lodrave. Njëkohësisht shfrytëzoj rastin të kërkoj nga të gjithë importuesit që të mos sjellin lodra që janë jashtë standardeve të Bashkimit Evropian. Ideja ime nuk është dëmtimi i bizneseve, tregtarëve apo importuesit e lodrave, por kërkoj nga ta të importojnë lodra të standardeve evropiane", ka theksuar ministri Shala.

Ministri Shala ka thënë se inspektimet ndaj lodrave, por edhe produkteve të tjera do të shtohen që, sipas tij, janë pjesë e prioritetëve të

MITI-së. "Inspektimet do të vazhdojnë edhe do të jenë më të shpeshta sesa që kanë qenë deri më tani, dhe në inspektime do të marr pjesë edhe vetë. Por kërkoj edhe një herë nga të gjithë importuesit që në Kosovë të importojnë produkte që i plotësojnë standardet e Bashkimit Evropian. Me këtë formë e ruajmë të ardhmen e fëmijëve dhe të vendit tonë", ka thënë Shala. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka dërguar para disa muajve për analizë 15 lodra, që 12 nga to nuk i kanë kaluar testet e përdorimit.



Galeria e Ministrisë së Kulturës sjell ekspozitën 'Pullë postare' të autorit Haxhi Gjoni

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Më 25 tetor, në orën 19:00, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës (GMK) bëhet hapja e ekspozitës "Pullë postare" e autorit Haxhi Gjoni. Kësaj radhe hapësira ekspozuese e GMK-së do të mbulohet me një domen artesh skulpturore, ku autori Haxhi Gjoni shpërfaq kreativitetin e profilit të vet skulpturor, bërë me tehun e daltës. Kjo ekspozitë ka simbolikën e daktilografisë shprehëse, nisur me paraqitjen në medaljone të personazheve të mëdha siç është Nëna Terezë, e cila vjen si format pusulle ose

si pullë postare në kontekstin e gjenezës, prejardhjes dhe vizionit të saj prej paqeje botërore. "Skënderbeu", "Koka e shqiponjës", "Familja e murosur në gur", "Hyjnesha në fron", "Mikelanxhelo", "Koka e kalit" etj., janë disa prej punimeve të tij me të cilat paraqet identitete historike, të farkëtuara në kulturën e gurit afrikan, indian apo ballkanik. Ekspozita financohet dhe drejtohet nga Galeria e Ministrisë së Kulturës, ndërkaq kurator i ekspozitës është Naser Shatrolli.



Gashi premton përkrahje për stafin e Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Soboc

OBILIQ, 22 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka vizituar Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Soboc, me rastin e mbarimit të punimeve dhe fillimit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore. "Sot së bashku me drejtorin e DShMS-së,

Ibush Mjekiqi, kryesuesin e kuvendit, Burim Gërguri dhe me bashkëpunëtorë, vizitova dhe urova stafin mjekësor të cilëve u premtova përkrahje edhe në të ardhmen", ka bërë me dije Gashi. Po në fshatin Siboc kryetari Gashi ka vizituar edhe Shkollën Filllore të

Mesme të Ulët "Migjeni", ku është takuar me drejtorin Bashkim Ismajli. "Diskutuam për shumë çështje që e shqetësojnë stafin arsimor këtu. U zotova se prioritet imi do të mbetet edhe më tutje arsimit, kështu që mbështetja nuk do të mungoj", ka thënë Gashi.



Në Mitrovicë do të ndërtohen edhe tre lapidarë

MITROVICË, 22 TETOR - Bordi i drejtorëve të Komunës së Mitrovicës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, e cila është drejtuar nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri. Në këtë mbledhje është shqyrtuar draftraporti i auditimit "Menaxhimi i të hyrave vetjake në nivel komunal". Pasi u njoftuan për të gjeturat e auditorit lidhur me këtë çështje, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka kërkuar nga drejtorët e drejtorive komunale që t'i planifikojnë dhe realizojnë të hyrat e tyre. Ai u tha drejtorëve se deri në fund të këtij muaji duhet t'oj japin përgjigjet e tyre

se a pajtohen apo jo me të gjeturat e auditorit. Pikë tjetër e rendit të ditës që u shqyrtua në mbledhjen e bordit ishte edhe ajo lidhur me formimin e listave të menaxhimit të rrezeve për të gjitha drejtoritë. U konstatua se është e domosdoshme që drejtoritë komunale ta përgatisin listën e rrezeve kryesore, të cilat mund të paraqesin probleme eventuale në veprimtaritë përkatëse. Bordi i drejtorëve ka shqyrtuar edhe përgatitjet e deritashme për realizimin e projekteve për tre lapidarët e paraparë për realizim gjatë këtij viti.

U konstatua se lapidari i minorëve dhe ai i viktimeve të sulmit barbar të okupatorit serb në tregun kryesor të qytetit janë në fazë të tenderimit dhe se mund të realizohen brenda afatit të paraparë. Po ashtu, u konstatua se edhe përmendorja e Adem Jasharit mund të jetë gati për përirim në afatin e përcaktuar më parë. Kryetari i komunës, Agim Bahtiri, edhe në këtë takim të bordit të drejtorëve kërkoi angazhim maksimal të inspektorëve komunalë dhe të gjithë faktorëve të tjerë për parandalimin dhe ndërprerjen e ndërtimeve pa leje.

Kryeprokurori Kurmehaj viziton pesë stacionet policore të rajonit të Pejës

PEJË, 22 TETOR (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Pejës, Agim Kurmehaj, ka vizituar pesë stacione policore: të Pejës, të Klinës, të Istogut, të Deçanit dhe të Junikut, që janë nën kompetencë të kësaj prokurorie, me ç'rast është takuar me komandantët dhe shefat e hetimeve. Gjatë këtyre takimeve u diskutua për problemet aktuale të kriminalitetit në rajon të Pejës, por edhe dukurive kriminale që janë më karakteristike nëpër

stacionet policore përkatëse. Ata u morën vesh që me prioritet të trajtohen traste kur i dyshuari gjendet në ndalim policor, për procedurat e sekuestrimit dhe rastet e recidivizmit. Në këtë kontest u diskutua edhe për avancimin e bashkëpunimit në relacionin polici - prokurori. Vlen të theksohet se kjo është vizita e dytë që u bëhet stacioneve policore të rajonit të Pejës, gjatë këtij mandati nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Pejës, Agim Kurmehaj.



Bjellorusia shënon 75-vjetorin e vrasjeve masive të hebrenjve



MINUK, 22 TETOR - Autoritetet bjelloruse, diplomatët e huaj dhe përfaqësuesit e organizatave të hebrenjve janë mbledhur në Minsk për të marrë pjesë në ngjarjet që do të zgjasin për tri ditë me radhë, për ta përkujtuar vrasjen e mijëra hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këto ngjarje shënojnë 75-vjetorin e ekzekutimit të rreth 22 mijë

hebrenjve, të cilët ishin sjellë nga nazistët nga qytetet evropiane dhe u ekzekutuan nga 21-23 tetori i vitit 1943. Të hënën u mbajt një ngjarje në memorialin Yam të Minskut, ku mbi 5 000 persona po ashtu ishin vranë më 2 mars të vitit 1942. Në Bjellorusi gjatë këtyre tri ditëve do të mbahen koncerte, konferenca dhe do të shfaqen

dokumentare për t'i përkujtuar hebrenjtë e vranë. Para Luftës së Dytë Botërore, në Bjellorusi jetonin rreth 900 mijë hebrenj. Në një geto të krijuar në Minsk, pak kohë pas pushtimit më 1941 të Bashkimit Sovjetik nga Gjermania, aty ishin vendosur rreth 100 mijë hebrenj. Shumica e tyre u zhdrukën në Holokaust.

Çfarë parasheh Traktati për Armët Bërthamore?

Traktati për Armët Bërthamore, i nënshkruar në mes të ShBA-së dhe ish-Bashkimit Sovjetik më 1987, ka ndaluar përdorimin, posedimin dhe testimin e të gjitha raketave bërthamore dhe atyre jobërthamore me rreze të shkurtër dhe mesme veprimi, përveç armëve të nisura nga deti

UASHINGTON, 22 TETOR - I nënshkruar në mes të Shteteve të Bashkuara dhe ish-Bashkimit Sovjetik më 1987, Traktati për Armët Bërthamore ka ndaluar përdorimin, posedimin dhe testimin e të gjitha raketave bërthamore dhe atyre jobërthamore me rreze të shkurtër dhe mesme veprimi, përveç armëve të nisura nga deti. Pakti është nënshkruar afër përfundimit të Luftës së Ftohtë, periudhë kohore e cila është përshkruar si tejet tensionuese në mes të Shteteve të Bashkuara dhe ish-Bashkimit Sovjetik. Mirëpo presidenti amerikan Donald Trump ka thënë së fundmi se Shtetet e Bashkuara nuk do të lejojnë Rusinë "të krijojë armë derisa neve nuk na lejohe" një gjë e tillë. "Nuk e di pse presidenti amerikan Barack Obama nuk ka negociuar apo nuk është larguar", ka deklaruar Trump duke iu referuar këtij Traktati gjatë një tubimi në Nevada. Më 2014 presidenti Obama pati akuzuar Rusinë për shkelje të kësaj marrëveshjeje, pas dyshimeve se rusët kanë testuar raketa tokësore, megjithatë ai kishte vendosur të mos hiqte dorë nga pakti, edhe pas presionit të liderëve evropianë, të cilët kanë thënë se një vendim i tillë do të niste sërish garë armësh. Mirëpo, ShBA-ja ka insistuar se rusët kanë zhvilluar një raketë me rreze të mesme veprimi, të quajtur Novator 9M729. Kjo

raketë është thënë se i mundëson Rusisë të nisë sulme bërthamore drejt shteteve të NATO-s. Mirëpo Rusia ka komentuar pak këtë armë, përveç mohimit se është në kundërshtim me Traktatin e nënshkruar me ShBA-në.

Kongresi pa konsensus

Në Kongres nuk duket se ka ndonjë mendim të ndarë rreth asaj nëse presidenti amerikan Donald Trump është duke bërë vendimin e duhur për ta tërhequr ShBA-në nga marrëveshja për kontrollin e armëve me Rusinë. Senatori Rand Paul ka thënë se mendon që ky vendim do të ishte "gabim shumë i madh për t'u larguar nga marrëveshja historike. Ai ka thënë për "Fox News Sunday" se të dyja palët akuzojnë njëra-tjetrën për shkelje, ndërkohë që ai ka kërkuar "diskutime racionale" me ekspertët për të parë nëse Uashingtoni dhe Moska mund t'i zgjidhin dallimet.

Mirëpo senatori Lindsey Graham ka mbështetur Trumpin për vendimin e tij. "Absolutisht, vendimi i duhur. Rusët na kanë mashtruar", është shprehur ai për "Fox News".

Vendimi i Trumpit, "fatkeq"

Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Mass, ka thënë se synimi i



Trumpit për t'u larguar nga kjo marrëveshje me Rusinë është "fatkeq". Ai ka thënë në një deklaratë se Traktati është "shtyllë e rëndësishme për arkitekturën e sigurisë evropiane". Sipas tij, njoftimi i Trumpit "ngre pyetje të vështira për ne në Evropë". Përveç të tjerash, ai ka kërkuar nga Moska që t'i "qartësojë supozimet serioze për shkelje të Traktatit me ShBA-në, ndonëse Rusia mohon një gjë të tillë".

Britania "në linjë" me ShBA-në

Sekretari britanik i Mbrojtjes, Gavin Williamson, ka thënë se shteti i tij qëndron në linjë të njëjtë me ShBA-në lidhur me këtë Traktat. Williamson ka fajësuar Rusinë për rrezikim të Traktatit dhe i ka bërë thirrje Kremlinit ta "rregullojë shtëpinë e vet". Duke mbështetur Trumpin,

Williamson ka thënë për "Financial Times" se Moska është tallur me Traktatin për kontrollin e armëve. Rusia e cilëson vendimin e Trumpit "të rrezikshëm". Zëvendësministri i Jashtëm rus Sergei Ryabkov ka thënë se synimi i Trumpit për t'u larguar do të "ishite hap i rrezikshëm". Sipas tij, një vendim i tillë do të nxisë "dënim nga anëtarët më seriozë të komunitetit ndërkombëtar, të cilët janë të përkushtuar në sigurinë dhe stabilitetin e botës". Ndërkohë, udhëheqësi i Komitetit për Çështja të Jashtme në Dhomën e Lartë të Parlamentit të Rusisë, Konstatin Kosachev, ka thënë përmes një postimi në "Facebook" se tërheqja e ShBA-së nga kjo marrëveshje tregon se "njerëzimi është duke u përballur me kaos në fushën e armëve bërthamore". Në pesë dekadat e fundit ShBA-ja

dhe Rusia kanë nënshkruar një varg marrëveshjesh të përbashkëta për ta kufizuar arsenalin e tyre bërthamor. Hera e fundit kur autoritetet amerikane kanë tërhequr një pakt i madh, ka qenë më 2002, kur presidenti i atëhershëm amerikan, George W. Bush ka tërhequr ShBA-në nga Traktati i Raketave Anti-Balistike, e cila ka paraparë ndalimin e prodhimit të armëve që luftojnë raketat balistike. Pas këtij vendimi, presidenti rus Vladimir Putin ka deklaruar se Traktati për Armët Bërthamore nuk është më në shërbim të interesave të Rusisë. Kurse Trumpi, përveç që ka akuzuar Rusinë për shkelje të paktit, ka deklaruar se Amerika do të vazhdojë të zhvillojë raketa të cilat janë të ndaluara me këtë Traktat, përveç nëse Kina dhe Rusia pajtohen për të mos zhvilluar apo poseduar armë të tilla.

Rusi - Pakistan, manovra të përbashkëta

MOSKË, 22 TETOR - Pakistani dhe Rusia filluan stërvitjet e përbashkëta ushtarake vjetore për ta rritur bashkëpunimin kundër terrorizmit në përgjigje të kërcënimit në rritje të Shtetit Islamik që vjen nga Afganistani fqinj. Zyrtarët thonë se stërvitjet e

koduara me emrin "Druzhba-III" filluan të hënën në Qendrën Kombëtare Kundër Terrorizmit në qytetin malor Pabbi, ku është selia e njësisë komando të ushtrisë pakistaneze, Grupi i Shërbimeve Speciale. Zëdhënësi kryesor i Ushtrisë pakistaneze tha se kjo është

stërvitja e tretë e bashkëpunimit dypalësh të trajnimit Pakistan - Rusi. Zyrtarët ushtarakë rusë thanë se gjatë stërvitjes dyjavëshe më shumë se 70 trupa komando ruse dhe homologët e tyre pakistanezë do të ndërmarin veprime të përbashkëta në një lartësi prej 1 400 metrash.



E jashtëzakonshme

Makinat fluturuese, një ëndërr që po bëhet realitet

Ashtu si çdo risi teknologjike, makinat fluturuese po shikohen sot me kureshtje të përzier me dijeninë. Tashmë pritet që të projektohen makinat fluturuese. Dikur dukej si një iluzion, por ato pritet që të bëhen pjesë e përditshmërisë sonë. Bëhet fjalë vetëm për projekte ambicioze, por në dekadën e ardhshme



ndoshta disa nga këto mjete do të fillojnë të fluturojnë mbi kokat tona.

BARSOLETA E DITËS



- Zemër, dalim jashtë?
- Jo, jam e sëmurë.
- Në rregull, në rregull. Desha të ta blej një fustan.
- Uaaa... i dashur, po bëja shaka.
- Edhe unë shaka po bëja, zemër!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr




Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Një rrugë e përmbytur gjatë stuhive të rënda, ku 13 persona vdiqën në Francën jugperëndimore. Fotografia: Sylvain Thomas / AFP/

E rrallë

Minoreni peshkon krapin gjigant

Liçeni Scandarello i Amatrice nuk resht së surprizuari. Mëngjesin e së shtunës që lamë një i ri ka arritur të peshkojë një krap gjigant. Bëhet fjalë për një ekzemplar që peshon 25.2 kilogramë. Ishte 17-vjeçari Luke Mullet me ekipin e Uellsit ai që peshkoi krapin gjigant në garën Botërore të peshkimit të krapit.



DASHI

Edhe pse një objektiv duket i paarritshëm

për të tjerët, falë energjisë suaj dhe optimizmit do të arrini ta zgjidhni dhe madje ta superoni.



DEMI

Iniciativat në kohët e fundit kanë

rezultuar shumë produktive për ju dhe kjo ka bërë t'ju hapen dyer të reja për karrierën tuaj.



BINJAKËT

Forma fizike nuk do të jetë në nivelet

më të mira për ju sot, mbase duhet të bëni një kontroll rutinë për t'i shuar dyshimet.



GAFORRJA

Nuk jeni njeri i ekstremeve dhe gjërat

duhet të ndjekin një rregull të caktuar në ditën tuaj. Sot do të debatoni me një koleg.



LUANI

Jeni të ngarkuar me emocione

sot dhe dita do të jetë shumë e lëkundshme sa i përket çështjes së ndjenjave.



VIRGJËRISHA

Sot do të keni lajme të mira nga

të gjitha fushat e jetës. Intuita dhe racionaliteti do t'ju shoqërojnë në çaste të rëndësishme.



PESHORJA

Një atmosferë tensioni dhe ankthi

mbizotëron sot rreth jush. Për shkakun tuaj ose të dikujt tjetër sot do të ketë tone të larta në familje.



AKREPI

Shpejtësia është sinonimi i ditës suaj

sot. Në çdo veprim ose ngjarje do të mundoheni të jeni të shpejtë për ta mbyllur agjendën e ngarkuar.



SHIGJETARI

Sot të gjithë kanë objektivat e

tyre për të ndjekur dhe nuk mund të jenë pas jush në çastet që do të keni më shumë nevojë.



BRICJAPI

Nuk jeni dhe aq në humor sot për të

pranuar një shaka që do t'ju bëjë një miku juaj. Mbase nuk duhet ta merrni aq seriozisht situatën.



UJORI

Keni harxhuar aq shumë energji

përgjatë gjithë ditës që të mbaroni punë në kohë rekord dhe në mbrëmje do të ndiheni të lodhur.



PESHQIT

Në fushën sentimentale do

të jeni shumë të ëmbël dhe sot do t'i përkushtoheni partnerit dhe të gjithë kërkesave që ka.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ARSENAL - LEICESTER

1

LENS - AJACCIO GFCO

3+

SPARTA PRAGUE - MLADA BOLESNAV

1

Pajaziti: Prishtina e fortë, por triumfon Gjilani

Tri pikët e marra në ndeshjen ndaj Feronikelit në fundjavë e kanë motivuar trajnerin e Gjilanit, Sadat Pajaziti, i cili kërkon edhe tri pikë të reja në derbin me Prishtinën. "Ne do të angazhohemi maksimalisht që edhe në këtë ndeshje të arrijmë fitore dhe të vazhdojmë në këtë mënyrë deri në fund të sezonit vjeshtor", ka thënë Sadat Pajaziti



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 TETOR - KF Gjilani në fundjavën që e lamë pas e arriti një fitore shumë të rëndësishme në ndeshjen ndaj skuadrës lidere në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Feronikelit, për të cilën skuadër ishte edhe humbja e parë në këtë kampionat. Trajneri i Gjilanit, Sadat Pajaziti, të hënën për "Epokën e re" ka thënë se është shumë i kënaqur me faktin se skuadra e tij ka dalë triumfuese ndaj një kundërshtari të fortë siç është "Nikli" nga Drenasi. "Jam i kënaqur me lojën e shfaqur dhe fitoren e arritur ndaj Feronikelit. Jemi përgatitur mirë për atë ndeshje dhe ia kemi arritur qëllimit.

Kemi pasur në vazhduesi paraqitje të mira edhe në disa prej ndeshjeve të kaluara dhe kjo fitore ndaj një skuadre siç është Feronikeli na jep edhe më shumë motiv për ndeshjet e ardhshme", ka thënë Pajaziti. Në kuadër të xhiros së dymbëdhjetë në elitë, Gjilanin e pret edhe një tjetër ndeshje derbi, pasi luan ndaj skuadrës së Prishtinës. Kjo e fundit renditet në pozitën e dytë në renditjen tabelore kurse, sipas Pajazitit, Feronikeli dhe Prishtina janë skuadrat më të mira momentalisht në futbollin e Kosovës. Strategu nga Lugina e Preshevës kërkon maksimumin edhe në ndeshjen ndaj kryeqytetasve. "Normalisht se edhe ndeshja e radhës është mjaft e fortë, pasi përballemi me Prishtinën që, së

bashku me Feronikelin, janë dy skuadrat më të forta në futbollin e Kosovës. Me kënaqësi e pres ndeshjen ndaj Prishtinës, e cila do të sjellë një rivalitet të madh, por edhe një atmosferë në tribunë. Ne do të angazhohemi maksimalisht që edhe në këtë ndeshje të arrijmë fitore dhe të vazhdojmë në këtë mënyrë deri në fund të sezonit vjeshtor, pastaj kemi kohë të organizohemi edhe më shumë si skuadër dhe, pse jo, të angazhohim edhe ndonjë futbollistë", ka shtuar ai. Skuadra e Gjilanit renditet në pozitën e pestë me 17 pikë, gjashtë pikë më pak se skuadra kryesuese në ligë. Prej njëmbëdhjetë ndeshjeve të zhvilluara, Gjilani ka pesë fitore, dy barazime dhe katër humbje.

SHKURT

Modriqi i bën dhuratë me dedikim Kadri Veselit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pranuar një dhuratë nga futbollisti i Real Madridit, Luka Modriq. Modriq për dhuratë Veselit ia ka bërë një fanellë me dedikim. "Ndjenjë shumë e mirë të kesh një dhuratë si kjo, me dedikim personal nga futbollisti më i mirë në botë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

FFK-ja ndihmon klubet me topa

Federata e Futbollit e Kosovës me qëllim të mbështetjes së klubeve të futbollit, më 23 tetor, do të shpërndajë topa profesionalë për klubet e IPKO Superligës dhe të Ligës së Parë. Ndërsa do të vazhdojë t'i mbështesë edhe klubet e Ligës së Dytë dhe grupmoshat e reja. Nga 10 (dhjetë) topa do të shpërndahen nga ora 11:00 për skuadrat e IPKO Superligës dhe në orën 12:00 nga pesë topa për klubet e Ligës së Parë.

Teuta - Bashkimi përballen në Ligën Ballkanike

Pas humbjes në xhiron e parë në Ligën Ballkanike (BIBL), kampioni i Kosovës në basketboll, Bashkimi, do të luajë në udhëtim ndaj Teutës nga Durrësi në kuadër të xhiros së dytë. Kjo ndeshje luhet të martën në Durrës dhe nis në orën 19:00. Bashkimi në xhiron e parë pësoi në shtëpi nga Beroe, kurse Teuta që debutoi në BIBL e nisi me fitore ndaj Akademik Bultexit (89:86). Bashkimi është nënkampion i BIBL-it.

Nuza dhe Berisha në ndeshjet kualifikuese për Evropianin U17

UEFA dhe FIFA gjithnjë e më shumë po u japin hapësirë gjyqtarëve të Kosovës falë paraqitjes së tyre jashtëzakonisht të mirë që po tregojnë në garat ndërkombëtare. Gjyqtari kryesor Genc Nuza dhe gjyqtari anësor Fatlum Berisha sot (e martë) udhëtojnë për në Turqi, ku do ta ndajnë drejtësinë në ndeshjet kualifikuese për kampionatin evropian të grupmoshës U17. Në këtë grup marrin pjesë Turqia, Irlanda e Veriut, Sllovakia dhe San Marino.

Sot në Prishtinë nis "IHF Trophy" në hendboll

PRISHTINË, 22 TETOR - Sot (e martë) në Prishtinë do të nisë turneu "IHF Trophy" për gjeneratat U-18dh e U-20, të cilin do ta organizojë Federata e Hendbollit e Kosovës (FHK). Ky turne i është besuar FKH-së pas negociatave të gjata me Federatën Ndërkombëtare të Hendbollit

(IHF). Ndeshjet për grupmoshën U-18 të këtij turneu do të zhvillohen në palestrën "1 Tetori" në Prishtinë.

Ekipi U-18 i Kosovës ka në grup Shqipërinë, Moldavinë dhe Britaninë e Madhe. Në xhiron e parë, që nis të martën, Kosova prej orës 16:00 do të përballlet me

Britaninë e Madhe, kurse prej orës 14:00 do të luajnë Moldavia dhe Shqipëria. Ndërkohë, ndeshjet e grupmoshës U-20 do të zhvillohen në palestrën e vogël të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve. Kosova U-20 është në një grup me Gjeorgjinë, Britaninë e Madhe, Irlandën,

Maltën dhe Moldavinë. Edhe xhiroja e parë e kësaj grupmoshe nis të martën (23 tetor) dhe Kosova do të përballlet me Britaninë e Madhe (18:00). Çiftet e tjera të xhiros së parë janë: Moldavia - Irlanda (14:00) dhe Malta - Gjeorgjia (16:00). FHK-ja javë më parë tetorin e ka

shpallur "Muaj të Hendbollit" për shkak të aktiviteteve të shumta. Këtë muaj edhe Përfaqësuesja e Kosovës do të luajë dy ndeshje në kuadër të eliminatorëve për "Euro 2020", ku do të përballlet me gigantet: Poloninë (24 tetor) dhe Gjermaninë (28 tetor).

Ibra shihet si shpëtimtar i Realit

Madrid, 22 tetor - Zlatan Ibrahimoviç mund të rikthehet në La Liga pas përvojës jo fort pozitive me Barcelonën në sezonin 2009-2010. Largimi i Cristiano Ronaldos ka lënë një bosh-

llëk në sulmin e Real Madridit, kurse ekipi i Lopeteguit po kalon një krizë rezultatesh dhe golash. Neymari dhe Kilian Mbappe janë objektivat e Realit, por është e pamundur për të

arritur te njëri nga sulmuesit e PSG-së në afatin kalimtar të janarit. Zgjidhja? Florentino Perez e ka një ide. Pa shumë shpenzime dhe një lojtar që siguron gola. Siç citon "AS", kreu i klubit po

mendon ta ofrojë Zlatan Ibrahimoviçin në janar. Një sfidë me Realin do të ishte maksimumi në mbyllje të karrierës, me Ibrën që dëshiron të rikthehet protagonist në futbollin evropian.



Rikthehet Liga e Kampionëve, Ronaldo kundërshtar i Unitedit

United, 22 tetor - Ylli portugez Cristiano Ronaldo rikthehet sonte (e martë) në "Old Trafford", por këtë herë jo për ta ndihmuar skuadrën e Manchester Unitedit, por për të luajtur kundër saj. Juventusit në këtë ndeshje hynë pas dy fitoreve në ndeshjet e para, kurse Unitedi ka një fitore dhe një barazim. Të dyja skuadrat në ndeshjet e fundjavës në kampionatet përkatëse luajtën baras, ani pse skuadra e Unitedit e kishte kundërshtarin më të vështirë. Shqetësim i vogël i Juves për ndeshjen e Ligës së Kampionëve është lëndimi i Paulo Dybala në ndeshjen miqësore në mes të Brazilit dhe Argentinës, por edhe në mungesë të Dybalas në formacionin e skuadrës italiane janë edhe yjet e tjerë si Ronaldo, Mandzuciq, Pjaniç, Chiellini dhe Bonucci. Ndërsa Unitedi nuk ka treguar formë të mirë në këtë edicion, por paraqitja e Anthony Martial jep shpresë për një rezultat të mirë. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 21:00, derisa ndeshja tjetër e këtij grupi zhvillohet në Zvicër në mes të Young Boys - Valencia (18:45). Në Grupin G, Real Madridi që është kampione në fuqi të Evropës e pret skuadrën e Viktoria Plzenit dhe kërkon tri



pikët e plota për faktin se nga dy ndeshja ka regjistruar vetëm një fitore dhe zë vendin e dytë në

grup. Ndeshja tjetër e këtij grupi zhvillohet në mes të Romës dhe CSKA Moskës.

GRUPI E			GRUPI G		
18:55 AEK Athens - Bayern Munich			21:00 Real Madrid - Viktoria P.		
21:00 Ajax - Benfica			21:00 Roma - CSKA M.		
TABELA		PIKË	TABELA		PIKË
1. Ajax	2	4	1. CSKA M.	2	4
2. Bayern M.	2	4	2. Real Madrid	2	3
3. Benfica	2	3	3. Roma	2	3
4. AEK Athens	2	0	4. Viktoria P.	2	1
GRUPI F			GRUPI H		
21:00 Hoffenheim - Lyon			18:55 Young Boys - Valencia		
21:00 Shakhtar D. - Manchester City			21:00 Manchester United - Juventus		
TABELA		PIKË	TABELA		PIKË
1. Lyon	2	4	1. Juventus	2	6
2. Manchester C.	2	3	2. Manchester U.	2	4
3. Shakhtar D.	2	2	3. Valencia	2	1
4. Hoffenheim	2	1	4. Young Boys	2	0

Ndalet Golden State. 'Kavaljerët' nuk ngrenë kokë

OAKLAND, 22 TETOR - Golden State ka pësuar humbjen e parë në këtë fillimsezon të kampionatit amerikan të basketbollit, NBA. Skuadra kampione në fuqi u mposht nga Denveri 100-98, me Nuggetsin që vazhdon ta ruajë pathyeshmërinë e tij. Golden State duket se nuk ishte në mbrëmjen e saj më të mirë dhe në periudhën e katërt të sfidës e pa veten në disavantazhin e 13 pikëve. Pikërisht në këtë moment, Stephen Curry e lojtarët e tjerë të "Warriors"-ave arritën ta shkurtonin diferencën në 2 pikë duke regjistruar një rezultat të pjesshëm 21-8. Në sekondat e fundit, Curry hapi panik te mbrojtja e Denverit, teksa dha një asistim te Damian Jones, por ky i fundit u frenua nga Hernan Gomez, me spanjollin që i dha këtë fitore me vlera skuadrës së tij. Clevelandi vijon të mos ngre-



jë kokë. Nënkampionët e NBA-së pësuan humbjen e tretë radhazi. Këtë radhë ajo erdhi nga Atlanta, me rezultatit 133-111. Njeriu i ndeshjes për Hawksin u bë Youngu, me ish-basketbollistin e Oklahomës që shkëlqeu në parket, teksa e mbylli ndeshjen me 35 pikë dhe 11 asistime. Atlanta e dominoi totalisht ndeshjen me Clevelandin, që edhe këtë radhë tregoi se ka probleme të shumta në aspektin mbrojtës të lojës së tij. Për më tepër, Atlanta vendosi në këtë ndeshje edhe një rekord,

teksa regjistroi 22 gjuajtje të sakta nga distanca e tri pikëve. "Cavaliers"-at detyrohen ta shtynjë sërish takimin me fitoren e parë sezonale. Humbje pësoi edhe Oklahoma, që u thye nën parketin e saj nga Sacramento Kings me rezultatit 120-131, duke shënuar disfatën e tretë radhazi. Russell Westbrook e bëri debutimin e tij për këtë sezon, por prania e tij në parket nuk u mjaftoi "Thunder"-ave. Westbrooku u përpoq ta lërë shenjën e tij dhe e mbylli ndeshjen me 32 pikë, 12 topa në tabelë dhe 8 asistime, statistika këto që nuk e ndihmuan Oklahomën. Ekipi tek-san nuk e niste sezonin e NBA-së me një bilanc me tri humbje që nga viti 2008. Për Sacramento, ai që spikati ishte Shumpert me 26 pikë, ndërkohë që mjaft mirë u paraqit edhe Foxi, me 22 pikë e 10 asistime.

SHKURT

Presidenti i Barcelonës: Nuk e rikthejmë Neymarin

Presidenti i Barcelonës, Josep Mara Bartomeu, përgënjeshtroi spekulimet e fundit mediatike që lidhin një rikthim të mundshëm të yllit brazilian, Neymar, në "Camp Nou". "Neymar? U largua pa e kthyer kokën pas dhe ne nuk kemi as qëllimin më të vogël të bëjmë ndonjë lëvizje për të. Për më tepër, në afatin kalimtar të janarit mendojmë të mos jemi shumë aktivë, vetëm në rast se trajneri do të kërkojë ndonjë emër specifik. Mund t'i referohemi Barcelonës B, ku ka elementë që mund të integrohen edhe në skuadrën e parë", ka thënë Bartomeu.

Marcelo, në janar te Juventusit

Mbrojtësi i Real Madridit, Marcelo, në janar mund t'i bashkohet skuadrës së Juventusit. Njëpërmjet një lajmi ekskluziv, gazeta italiane "Tuttosport" zbulon se braziliani dëshiron bardhezinjtë dhe transferimi pritet të vijë që në janar. Gazeta italiane zbulon se orët e fundit Marcelo nëpërmjet agentëve të vet u ka kërkuar drejtuesve madrilënë largimin. Një arsye pse 30-vjeçari kërkon të largohet është edhe ecuria negative e Realit javët e fundit. Braziliani kërkon të bashkohet me shokun e vet Cristiano Ronaldo dhe është në bisedime të vazhdueshme me të. Blerja e Marcelos te Juventusit pritet të financohet nga shitja e Alex Sandros në Premierë Ligë.

Gravina, president i Federatës së Futbollit të Italisë

Gabriele Gravina është zgjedhur president i ri i Federatës së Futbollit të Italisë (FIGC). Gravina u zgjodh president i FIGC pasi mori 97.2 për qind të votave në asamblenë zgjedhore të hënën, pasi ishte kandidati i vetëm për ta zëvendësuar Carlo Tavecchion, raportojnë mediet italiane. 65-vjeçari më herët ka qenë kryetar i Lega Pro, organit qeverisës të Serisë C - nivelit të tretë të futbollit italian. Gravina njihet në Itali edhe për periudhën e tij si president i Castel di Sangro, duke i ndihmuar klubit të promovohet pesë herë edhe në Serinë B në vitet 1990.

Nainggolani mungon ndaj Barçës

Interi fitoi derbin ndaj Milanit (1-0), por që e humbi mesfushorin Radja Nainggolanin, i cili u zëvendësua në pjesën e parë. Skuadra italiane ka lëshuar një njoftim zyrtar, duke bërë me dije se mesfushori belg do të mungojë për disa javë. Nainggolan do të mungojë në përballjen e Interit ndaj Barcelonës në kuadër të Ligës së Kampionëve. Lajmi i vetëm i mirë për nerazurët është që Perisiq dhe Brozoviç do të jenë të gatshëm për përballjen në 'Camp Nou'.

Pezullime dhe gjoba për protagonistët e sherrit në ndeshjen Lakers - Houston

NBA ka përdorur dorë të hekurt për 3 lojtarë, shaktarë të një sherrit masiv në ndeshjen e basketbollit në mes të Lakersit dhe Houston Rocketsit, luajtur dy ditë më parë në "Staples Center" të Los Anxhelosit. Dy lojtarë të Lakersit dhe një i Houstonit janë pezulluar me disa ndeshje dhe gjobitur. Rajon Rondo i Lakersit është pezulluar me tri ndeshje si dhe do të paguajë një gjobë prej 186 mijë dollarësh, ndërsa shoku i tij i skuadrës, Brandon Ingram, është pezulluar me katër ndeshje dhe gjobitur me 158 mijë dollarë. Nuk i ka shpëtuar dënimit edhe Chris Paul, i pezulluar dy ndeshje (një e shleu, pasi nuk luajti sot ndaj Clippersit) dhe 491 mijë dollarë. Në mesin e periudhës së katërt të ndeshjes Lakers - Houston (fituar 124-114 nga miqtë), Paul e Rondo u bënë protagonistë të një sherrit, ku nuk munguan edhe grushtet. Në këtë sherr ndërhyri edhe Ingram e disa lojtarë të tjerë, duke bërë që ndeshja të ndërpritet për disa minuta dhe tre basketbollistët ta lënë lojën me teknikë përjashtimi.

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: SHFMU "HAMËZ THAÇI" - XËRXË

Komuna: RAHOVEC

Data: 23.10.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/095-CS/1.1	Trajnim per mesimdhene per TIK

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollën "HAMËZ THAÇI" XËRXË, RAHOVEC.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnim per mesimdhene per TIK

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "Hamëz Thaçi" Xërxë, Rahovec, më së largu deri më 31.10. 2018.

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Setki Kryeziu

Telefoni: 044/366254

E-maili: setkikryeziu@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Zylia Kalisi shpall te pavlefshme diplomën e SH.M.L "Dardania" Hani Elezit.

► Didem Cibo shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren.

► Amdi Elezi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Ekrem Rexha Drini" Lubizhd

► Nazmi Mucaj shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Adelina Muqaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

► Resul Maqaj shpall te pavlefshme dëftesat diplomën certifikatat SHMM "Luciano Motroni" Prizren

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralia Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë e përshtatshme dhe për banim kolektiv. Tel. 044-413-197, wiber: 045-198-095.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**ANKAND PUBLIK****PËR SHITJEN E INVENTARIT JASHTË PËRDORIMIT****Shitet :**

- Sasi e konsideruar e inventarit të vjetruar të teknologjisë informative (aparate elektronike-elektrike, dhe inventar nga druri,metali);shtëpizë, monitor, printera, UPS, fotokopjues, fladitëse, fotoaparati digjital, tavolina, karriga të tërhequra nga zyret e Komunës, zyret e Gjendjes Civile, zyret e Entit Social, nga Shkollat e qytetit, zyret e QKMF, të vendosura dhe grumbulluara në depon e cila gjendet në objektin e gjimnazit te vjeter, ish QAP dhe QKMF nr.2 :
- Lavatriqe madhe e vjetruar (jashtëpërdorimit) në oborrin e QKMF nr.2
- Gjeneratori i vjetruar i cili gjendet mbrapa ndërtesës së Komunës
- Automjetet e vjetruara (jashtëpërdorimit) me lokacion në oborrin e QKMF nr.2 :
 - Kombi i tipit *WW* pa tabela (e QKMF)
 - Kombi i tipit *TOYOTA* pa tabela (e QKMF)
 - Kombi i tipit *FIAT* pa tabela (e QKMF)
 - Autoambulancë e tipit *OPEL- Omega* pa tabela (e QKMF)
 - Veturë e tipit *LADA NIVA* pa tabela (e QKMF)
 - Veturë e tipit *MERCEDES* pa tabela (i Komunës)
 - Veturë e tipit *AUDI* pa tabela (i Komunës)
 - Veturë i tipit *MERCEDES* pa tabela (i Komunës)
 - Autoambulancë e tipit *FIAT* pa tabela (e QKMF)
- Automjetet e vjetruara (jashtëpërdorimit) me lokacion në oborrin e zjarfikësve: 12 Kombi i tipit *TOYOTA* pa tabela (i SH.M.U "Ahmet Hoxha")

Komisioni për shitjen e këtij inventari, ka përcaktuar çmimin fillestar për inventarin e Teknologjisë informative, inventarin metalik dhe automjetet zyrtare të jetë çmimi i përbashkët fillestar : **6000,00.00€**


Të interesuarit, inventarin e cekur më lartë mund të shikojnë për çdo ditë pune duke filluar nga ora **10 : 00** deri në ora **12:00**, në prezencë të komisionit për shitje, në këto lokacione:



- Objekti i Komunës në rrugën "Dëshmorët e Kombit"
- Objekti i QAP në rrugën "Ramadan Rexhepi"
- Tek oborri i QKMF nr.2 në rrugën "Cen Dugolli"
- Oborri i Zjarfikësve në rrugën "Cen Dugolli"

Të drejtë pjesëmarrje në këtë ankand publik kanë të gjithë personat juridik dhe fizik, të cilët paraprakisht duhet ti deponojnë nga 50,00 € si çmim fillestar.

Shitja do të bëhet në vendin ku ndodhet inventari.

Drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E PRIZRENIT • OPŠTINA PRIZREN – PRIZREN BELEDIYESI
 Nr. 01-117/18
 Datë: 18.10.2018

Nr. 01/117/18 Dt. 18.10.2018

Në bazë të nenit 8 paragraf 5 dhe nenit 4 paragraf 2, pika 2.4.3.3 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-205 të dt: 28.10.2010, Organi Shpronësues-Kryetari i Komunës së Prizrenit pas shqyrtimit të Kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike të dt: 11.09.2018, me qëllim të realizimit të Projektit për Vendosijen e gypit shkarkues nga Impianti deri te Lumbardhi, nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 të dt: 20.02.2010, nenit 13, 109 si dhe nenit 82 të LPA-së nr.02/L-28 të dt:22.07.2005, merr këtë :

V E N D I M

I. PRANOHET si qëllim i ligjshëm publik dhe e bazuar kërkesa për shpronësimin e pronave të paluajtshme në parcelat kadastrale në pjesët e të cilave duhet të realizohet projekti për Vendosijen e gypit shkarkues nga Impianti deri te Lumbardhi me të dhënat e përshkuara sipas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike të dt: 11.09.2018.

II. Kërkesa për shpronësim në fjalë do të shqyrtohet në procedurë të mëtejme me qëllim të Realizimit të projektit për Vendosijen e gypit shkarkues nga Impianti deri te Lumbardhi për ZK Vlashnjë.

A r s y e t i m

Drejtoria e Shërbimeve Publike me kërkesën e vet më dt: 11.09.2018, ka kërkuar shpronësimin e pronave të paluajtshme të cekura si në Kërkesën e datës së të cekur më lartë, të cilat gjenden në ZK Vlashnjë sipas fletëve poseduese me të dhënat e përshkuara më afër në kërkesën për shpronësimin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Subjekti kërkesues me rastin e paraqitjes të kësaj kërkesë, të njëjtës ia ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme që parashihen në dispozitën e nenit 8. paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me nr. 03/L-205 të dt: 28.10.2010 të Republikës së Kosovës dhe atë:



- kërkesën për shpronësim,
- kopjet e listave poseduese dhe kopjet e planit për parcelat e shpronësuar,
- projektin për realizimin e impiantit dhe
- dokumentin për disponueshmërin e mjeteve financiare.

Organi shpronësues – Kryetari i Komunës ka pranuar kërkesën në fjalë të Drejtorisë për Shërbime Publike për shpronësimin e parcelave kadastrale me të dhënat e përshkuara si në kërkesë, ku kësaj kërkesë i është bashkangjitur edhe dokumenti përmes të cilit dëshmohet se Komuna e Prizrenit ka siguruar mjete të mjaftueshme financiare për pagimin me kohë të kompensimit në emër të shpronësimit të pjesëve të pronave të paluajtshme sa i përket realizimit të projektit.

Duke qenë se kërkesa në fjalë është e bazuar u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi dhe në pajtim me nenin 8 paragraf 5 lidhur me nenin 4. të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L-205 të Republikës së Kosovës.

Me këtë Vendim njoftohet:
 Subjekti kërkesues
 Arkivi
 Pala

Organi Shpronësues:
 Kryetari i Komunës
 Prof. Dr. Mytaz Haskuka

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E PRIZRENIT • OPŠTINA PRIZREN – PRIZREN BELEDIYESI
 Nr. 01-117/18
 Datë: 18.10.2018

Nr. 01/117/18 Dt. 18.10.2018

03/L-205 sayılı 28.10.2010 sayılı Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 8.maddesi 5. fıkrası ve 4.maddesi 2.fıkrası, 2.4.3.3. noktası gereğince, Prizren Belediye Başkanı-Kamulaştırma Makamı olarak Kamu Hizmetleri Müdürlüğü'nün 11.09.2018 tarihli talebini gördükten sonra İmpiyantan Akdere'ye dek boşaltım borusunun Yerleştirilmesi Projesinin gerçekleştirilmesi amaçlı, 03/L-040 sayılı 20.02.2010 tarihli Yerel Özyönetim Yasasının 13.maddesi, ayrıca 02/L-28 sayılı 22.07.2005 tarihli LPA 13.maddesi, 109.maddesi ve 82.maddesi gereğince şu karara vardı:

K A R A R

I. Kamu Hizmetleri Müdürlüğü 11.09.2018 tarihli talebi gereğince tanımlanan verilerle İmpiyant'tan Akdere'ye dek boşaltım borusunun yerleştirilmesi projesinin gerçekleştirilmesi için gerekli olan bölümlerdeki kadastro parsellerinde taşınmaz malların kamulaştırılması ile ilişkin talep asıllı olarak ve yasal kamusal amaçlı olarak **KABUL EDİLİYOR.**

II. Söz konusu kamulaştırma talebi Vlaşnje KB İmpiyant'tan Akdere'ye dek boşaltım borusunun yerleştirilmesi projesinin gerçekleştirilmesi amaçlı ilerki süreçte görülecektir.

A ç ı k l a m a

Kamu Hizmetleri Müdürlüğü 11.09.2018 tarihli talebi ile, yukarıda belirtilen tarihli, Kamu Hizmetleri Müdürlüğü'nün kamulaştırma talebinde daha ayrıntılı olarak tanımlanan, emlak belgeleri gereğince Vlaşnje KB bulunan taşınmaz malların kamulaştırılmasını talep etti.

Talebi sunan oluşum işbu talebi sunarken aynı zamanda Kosova Cumhuriyeti'nin 03/L-205 sayılı 28.10.2010 sayılı Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 8.maddesi 2. ve 3. fıkrası hükümleri gereğince öngülen gerekli tüm belgeleri de eklemiştir ve o da şu şekilde:



- Kamulaştırma talebi,
- Emlak belgesi kopyası ve kamulaştırılan parsellerin plan kopyası,
- İmpianti gerçekleştirme projesi ve
- Maddi kaynakların var olduğuna dair belge.

Kamulaştırma Makamı-Belediye Başkanı tanımlanan verilerle kadastro parsellerin kamulaştırılması için Kamu Hizmetleri Müdürlüğü'nün söz konusu talebini kabul etti, işbu talebe Prizren Belediyesinin projeyi gerçekleştirmekle ilişkin taşınmaz malların parçalarını kamulaştırma adına tazminatı zamanında ödeyecek şekilde finansal kaynakların yeterli olduğunu temin ettiğini doğrulayan belge de eklenmiştir.

Talep asıllı olarak bulunduğu için Kararın giriş kısmındaki hüküm ayrıca Kosova Cumhuriyeti'nin 03/L-205 sayılı 28.10.2010 sayılı Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 4.maddesi ile ilişkin 8.maddesi 5. fıkrası ayrıca karar verilmiştir.

Karar ile bildirilmeli:
 Talep eden oluşum
 Arşiv
 Taraf

Organi Kamulaştırma makamı:
 Belediye Başkanı
 Prof. Dr. Mytaz Haskuka

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E PRIZRENIT • OPŠTINA PRIZREN – PRIZREN BELEDIYESI
 Nr. 01-117/18
 Dana: 18.10.2018

Nr. 01/117/18 Dt. 18.10.2018

Na osnovu člana 8 paragraf 5 i člana 4 paragraf 2, tačka 2.4.3.3 Zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-139 o Eksproprijaciji Nepokretne Imovine Br.03/L-205 od dana 28.10.2010, Organ Eksproprijacije-Predsednik Opštine nakon razmatranja zahteva Direktorijata za Javne Usluge od dana 11.09.2018, u cilju realizacije Projekta za postavljanje cevi za odvođenje od Impianta do reke Lumëbardhi, člana 13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 od dana 20.02.2010, člana 13, 109 kao i člana 82 ZUP-a Br.02/L-28 od dana 22.07.2005, donosi ovu:

O D L U K U

I. PRIHVATA SE kao zakonski javni cilj i osnovan za eksproprijaciju nepokretne imovine na katastarskim parcelama, na kojim delovima imovine treba da se realizuje projekat za postavljanje cevi za odvođenje od Impianta do reke Lumëbardhi, sa opisanim podacima prema zahtevu Direktorijata za Javne Usluge od dana 11.09.2018.

II. Zahtev za navedenu eksproprijaciju razmatraće se u daljnjoj proceduri, a u cilju realizacije projekta za postavljanje cevi za odvođenje od impijanta do reke Lumëbardhi prema KZ Vljašnje.

O b r a z l o ž e n j e

Direktorijata za Javne Usluge svojim zahtevom od dana 11.09.2018, zahtevao je eksproprijaciju nepokretnih imovina, navedenih u zahtevu gore navedenog datuma, koje se nalaze u KZ Vljašnje, prema posedovnoj listi, sa bliže opisanim podacima za eksproprijaciju od strane Direktorijata za Javne Usluge.

Podnosioc zahteva prilikom podnošenja ovog zahteva, istom je priložio sva potrebna dokumenta, koji se predviđaju u odredbi člana 8 paragraf 2 i 3 Zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine Br.03/L-205 od dana 28.10.2010 Republike Kosova, i to:



- Zahtev za eksproprijaciju,
- Kopije posedovnih lista i kopije plana za eksproprijaciju parcele,
- Projekat za realizaciju Impijanta, i
- Dokumentat o raspolaganju finansijskih sredstava.

Organ eksproprijacije – Predsednik Opštine primio je navedeni Direktorijata za Javne Usluge za eksproprijaciju katastarskih parcela sa opisanim podacima kao u zahtevu, gde je ovom zahtevu priložen i dokumentat se kojim se dokazuje da je Opština Prizren obezbedila dovoljna finansijska sredstva za pravovremenu isplatu nadoknade na ime eksproprijacije delova nepokretnih imovina, što se tiče realizacije projekta.

S' obzirom da je navedeni zahtev osnovan, odlučeno je kao u dispozitivu ove Odluke i u skladu sa članom 8 paragraf 5 vezano sa članom 4 Zakona o Izmenama i Dopunama Zakona Br. 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretnih Imovina Br. 03/L-205 Republike Kosova.

Sa ovom Odlukom upoznati:
 Podnosioca zahteva
 Arhivu
 Stranka

